



## **TË CERTIFIKUARIT NGA QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL 2021: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR**

Një projekt i Agjencisë Zviceriane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC


 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
  
Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:

  
swisscontact



**TË CERTIFIKUARIT NGA QENDRAT  
E FORMIMIT PROFESIONAL 2021:  
GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR**

Tetor 2022



## **TË CERTIFIKUARIT NGA QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL 2021: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR**

Tetor 2022

Ky publikim është realizuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikëqyrjen e Menaxherit të Projektit, Fation Dragoshi. Raporti u përgatit nga Assoc. Prof. Eglantina Hysa, konsulente dhe Assoc. Prof. Ines Nurja, konsulente për metodologjinë.

### **Rreth projektit “Aftësi për Punë”**

“Aftësi për Punë” (S4J), është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Ansimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri, duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së, në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim, nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

# TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                                         |           |
|-------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>                                           | <b>5</b>  |
| <b>1. HYRJE</b>                                                         | <b>11</b> |
| <b>2. METODOLOGJIA</b>                                                  | <b>13</b> |
| Qasja metodologjike                                                     | 13        |
| Instrumenti i studimit - pyetësoni                                      | 13        |
| Analizimi i të dhënave                                                  | 15        |
| Kufizimet metodologjike                                                 | 15        |
| <b>3. PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË</b>                                      | <b>16</b> |
| <b>4. REZULTATET</b>                                                    | <b>18</b> |
| <b>4.1 SITUATA E PUNËSIMIT TË TË CERTIFIKUARVE</b>                      | <b>19</b> |
| Situata aktuale e punësimit                                             | 19        |
| <b>4.2 TË CERTIFIKUARIT E PUNËSUAR</b>                                  | <b>23</b> |
| Integrimi në tregun e punës – karakteristikat kryesore në punën aktuale | 23        |
| Integrimi në tregun e punës – të ardhurat                               | 27        |
| Integrimi në tregun e punës – përputhshmëria e trajnimit                | 30        |
| <b>4.3 TË CERTIFIKUARIT E VETËPUNËSUAR</b>                              | <b>32</b> |
| Lidhja e kursit me punën                                                | 33        |
| Detaje të tjera në lidhje me sipërmarrjen                               | 34        |
| <b>4.4 TË CERTIFIKUARIT E PAPUNË</b>                                    | <b>35</b> |
| Të kërkuarit për punë                                                   | 37        |
| Marrëdhënia me zyrat e punës                                            | 38        |
| <b>4.5 TË CERTIFIKUARIT JOAKTIVË NË TREGUN E PUNËS</b>                  | <b>40</b> |
| Student/Kursant në trajnime të mëtejshme                                | 41        |
| <b>4.6 VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË CERTIFIKUARVE</b>                    | <b>43</b> |
| Orientimi dhe këshillimi i qendrave të formimit                         | 47        |
| Pritshmëritë për dy vitet e ardhshme                                    | 47        |
| <b>5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b>                                   | <b>49</b> |
| <b>SHTOJCA Rezultatet sipas qendrave</b>                                | <b>52</b> |







# **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) me mbështetjen e projektit Aftësi për Punë (S4J), ndërmori gjurmimin në nivel kombëtar të të certifikuarve të vitit 2021 nga 10 qendrat e formimit profesional, me qëllimin e përgjithshëm të monitorimit të treguesve kryesorë të tregut të punës për të certifikuarit nga sistemi i AFP-së. Ky është raporti pasardhës i atij të gjurmimit kombëtar të të certifikuarve të vitit 2019.

Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të integrimit të të diplomuarve dhe të certifikuarve në tregun e punës dhe përfaqësojnë një burim të rëndësishëm për vlerësimin dhe mbështetjen në përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së arsimit dhe formimit profesional me tregun e punës. Nga 7837 të certifikuar nga 10 qendra të formimit profesional, 3981 iu përgjigjën sondazhit të gjurmimit gjatë periudhës prill-qershor 2022. Ky raport përshkruan dhe analizon të dhënat dhe rezultatet e përgjithshme për rrugëtimin profesional të të certifikuarve pas mbarimit të kursit, integrimin e tyre në tregun e punës, si dhe aspekte të tjera që mund të ndihmojnë drejt vlerësimit të orientimit drejt tregut të sistemit të AFP-së në Shqipëri. Disa nga gjetjet kryesore të sondazhit janë përmbledhur më poshtë:

- Nga të anketuarit për vitin 2021 (3981 gjithsej), 58.8% e tyre figurojnë të punësuar. Ndërkohë përqindja e të punësuarve për vitin 2019 ka qenë më e ulët (48.4%).
- Nga nënkategoritë e të punësuarve, të punësuarit zënë pjesën kryesore, me rreth 43.7%, duke u ndjekur nga të vetëpunësuarit me 14.4%, dhe së fundmi, me një përqindje të ulët të atyre që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë, me rreth 0.7%.
- 20.3% e të anketuarve janë të papunë, specifikisht 1639 gjithsej. Për vitin 2019, kjo kategori ishte 31.8%.
- Nga kategoria e joaktivëve, të papunët e dekurajuar ishin 13.1%, ata që janë në ndjekje të një kualifikimi të mëtejshëm ishin 5.4%, dhe ata që janë duke përmbushur detyrat shtëpiake ishin 0.5%.
- Ka dallime në shpërndarjen e statusit të punësimit sipas gjinisë. Të certifikuarit meshkuj ishin më të prirur se të certifikuarat femra për të qenë të punësuar, me 55.4% të meshkujve të punësuar, përkundrejt 44.6% të femrave.
- Të certifikuarit në qendrat Nr. 4 Tiranë, Durrës dhe qendrën Nr. 1 Tiranë, ishin më të prirur për të qenë të punësuar pas certifikimit, krahasuar me qendrat e tjera, përkatësisht 69.4%, 67.5% dhe 66.7%.
- Qendra e Lëvizshme tregon përqindje më të larta të të papunëve (përkatësisht, 38.3%), e ndjekur nga qendrat e Korçës (25.0%), Gjirokastrës (21.4%), Shkodrës (21.3%), dhe Elbasanit (21%).
- Të dhënat tregojnë se ka dallime të pagave sipas gjinisë, ku femrat janë më pak të paguara sesa meshkujt, specifikisht 66.7% e femrave rezultojnë me një pagë deri në 40.000 lek, përkundrejt 42.1% të meshkujve. E njëjta situatë është dhe për pagën mbi 95.000 lek, ku vetëm 1.0 % e femrave e sigurojnë këtë nivel, përkundrejt 3.9% të meshkujve.
- 32.5% e të certifikuarve në vitin 2021, kanë deklaruar rritje të të ardhurave të tyre pas mbarimit të kursit, shifër kjo më e lartë se ajo e vitit 2019, ku vetëm 28% kanë deklaruar rritje të të ardhurave.

- Pothuajse gjysma e të certifikuarve në marrëdhënie pune (55.6%), ndiheshin të sigurt në punën e tyre aktuale, dhe 27% kishin një perceptim neutral të sigurisë/stabilitetit në punën e tyre aktuale. Pjesa tjetër, ndihej e pasigurtë.
- Pothuajse gjysma e të certifikuarve të anketuar (54.3%) në vitin 2021, punojnë në subjekt të mesëm ose të madh, subjekt me më shumë se 10 punonjës, ndërsa për vitin 2019, kjo shifër rezulton të jetë disi më e lartë (58.4%).
- Të dhënat totale tregojnë se, 86.2% e të certifikuarve, kanë deklaruar se nëse do të kishin mundësi do të zgjidhnin të njëjtin kurs. Qendra e Gjirokastrës rezulton me përqindjen më të lartë, 96.5%, e shoqëruar nga DRFPP Durrës, 93.1%.
- Në lidhje me vlerësimin e indikatorëve të përdorur për të matur cilësinë e kursit profesional, në përgjithësi ka një përqasje pozitive kundrejt cilësisë së kursit. Aspektet më pak të vlerësuar nga të certifikuarit ishin “Bashkëpunimit me zyrat e punës”, “Bashkëpunimi me bizneset”, dhe “Orientimi në karrierë”, me përkatësisht 19%, 16.1% dhe 15.6%, ku gjithsesi, këto vlera nuk janë shumë negative.
- Nevoja për përmirësime në infrastrukturë, është gjetur të jetë më e lartë në qendrën e Shkodrës dhe në qendrën e Lëvizshme, me përkatësisht 22.4% dhe 21.8%. Ndërsa në qendrat e Elbasanit, Fierit, Korçës, dhe të Gjirokastrës mbi 90% e të diplomuarve ishin “shumë” ose “jashtëzakonisht shumë” të kënaqur me infrastrukturën.
- Nevoja për përmirësim të kurrikulave, është e dukshme në qendrën e Lëvizshme dhe atë të Shkodrës, me përkatësisht 19.8% dhe 17.6%, ndërsa në qendrat e Elbasanit, Korçës, dhe Fierit, nuk kanë shprehur nevojën për përmirësime në kurrikula.
- Si objektiv për të ardhmen, 15.5% e të anketuarve kanë qëllim të gjejnë një punë, 21.7% kanë qëllim të gjejnë një punë që të lidhet me fushën e studimit/trajnitimit, dhe 16.6% lidhen me sipërmarrjen ku duan të fillojnë biznesin e tyre.
- Në lidhje me dallimet gjinore, në 2 vitet e ardhshme, 21% e meshkujve kanë dëshirë të emigrojnë jashtë vendit, kundrejt 11.1% të femrave.



## Lista e tabelave

|                                                                  |    |
|------------------------------------------------------------------|----|
| Tabela 1 - Shpërndarja sipas gjinisë                             | 16 |
| Tabela 2 - Shpërndarja sipas Qendrave Profesionale               | 16 |
| Tabela 3 - Statusi i punësimit sipas qendrave për vitin 2021 (%) | 20 |
| Tabela 4 - Statusi i punësimit sipas qendrave për vitin 2019 (%) | 21 |
| Tabela 5 - Situata e punësimit sipas gjinisë (2021)              | 22 |
| Tabela 6 - Situata e punësimit sipas statusit etnik              | 23 |
| Tabela 7 - Arsytet e largimit nga puna                           | 37 |
| Tabela 8 - Mënyrat e kërkimit të punës                           | 37 |
| Tabela 9 - Arsytet që nuk kërkon punë                            | 38 |
| Tabela 10 - Regjistrimi në zynat e punës sipas gjinisë           | 38 |
| Tabela 11 - Institucioni arsimor i studimit sipas gjinisë        | 42 |
| Tabela 12 - Lidhja e studimeve me kursin sipas gjinisë           | 43 |
| Tabela 13 - Arsytet e zgjedhjes së kursit sipas gjinisë          | 44 |

## Lista e grafikëve

|                                                                                                  |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Grafiku 1 - Statusi i punësimit sipas kategorive për vitin 2019 dhe 2021 (%)                     | 19 |
| Grafiku 2- Situata e punësimit sipas gjinisë (2019-2021)                                         | 22 |
| Grafiku 3 - Kohëzgjatja në punë (2021)                                                           | 24 |
| Grafiku 4 - Mënyra e gjetjes së punës (2021)                                                     | 24 |
| Grafiku 5 - Punësimi në të njëjtin vend për vitin 2019 dhe 2021                                  | 25 |
| Grafiku 6 - Lloji i punësimit për vitin 2019 dhe 2021                                            | 25 |
| Grafiku 7 - Lloji i punësimit sipas gjinisë (2021)                                               | 25 |
| Grafiku 8 - Madhësia e subjektit (2021)                                                          | 26 |
| Grafiku 9 - Madhësia e subjektit (2019)                                                          | 26 |
| Grafiku 10 - Kontrata e punës për vitin 2019 dhe 2021                                            | 26 |
| Grafiku 11 - Qëndrueshmëria në punën aktuale (2021)                                              | 27 |
| Grafiku 12 - Qëndrueshmëria në punën aktuale sipas gjinisë (2021)                                | 27 |
| Grafiku 13 - Të ardhurat mujore nga puna (2021)                                                  | 28 |
| Grafiku 14 - Të ardhurat mujore nga puna (2019)                                                  | 28 |
| Grafiku 15 - Shpërndarja e të ardhurave sipas gjinisë (2021)                                     | 29 |
| Grafiku 16 - Shpërndarja e të ardhurave sipas statusit të punësimit (2021)                       | 29 |
| Grafiku 17 - Shpërndarja e të ardhurave sipas statusit të punësimit (2021)                       | 30 |
| Grafiku 18 - Rritja e të ardhurave pas mbarimit të kursit për vitin 2019 dhe 2021                | 30 |
| Grafiku 19 - Lidhja e kursit me punën aktuale për vitin 2019 dhe 2021                            | 31 |
| Grafiku 20 - Arsyet e përzgjedhjes së një pune ndryshe nga ajo e trajnimit, sipas gjinisë (2021) | 31 |
| Grafiku 21 - Përdorimi i njohurive në punë, për vitin 2019 dhe 2021                              | 32 |
| Grafiku 22 - Përdorimi i njohurive në punë aktuale, sipas situatës së punësimit (2021)           | 32 |
| Grafiku 23 - Shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas qendrave (2021)                               | 33 |
| Grafiku 24 - Lidhja e fushës së biznesit me trajnimin, për vitin 2019 dhe 2021                   | 33 |
| Grafiku 25 - Lidhja e fushës së biznesit me trajnimin, sipas gjinisë (2021)                      | 33 |
| Grafiku 26 - Koha për hapjen e biznesit, për vitin 2019 dhe 2021                                 | 34 |
| Grafiku 27 - Numri i të punësuarve në biznesin privat/familjar, për vitin 2019 dhe 2021          | 34 |
| Grafiku 28 - Perspektiva e vetëpunësimit për vitin 2019 dhe 2021                                 | 35 |
| Grafiku 29 - Shpërndarja e të papunëve sipas qendrave (2021)                                     | 35 |
| Grafiku 30 - Shpërndarja e të papunëve sipas qendrave dhe gjinisë (2021)                         | 36 |
| Grafiku 31 - Punësimi i mëparshëm për të papunët (2021)                                          | 36 |
| Grafiku 32 - Regjistrimi në zyrat e punës (2021)                                                 | 38 |
| Grafiku 33 - Ndihma e zyrave të punës (2021)                                                     | 39 |
| Grafiku 34 - Arsyet e mosregjistrimit për vitin 2019 dhe 2021                                    | 39 |
| Grafiku 35 - Situata e punësimit sipas kategorisë joaktive (2021)                                | 40 |
| Grafiku 36 - Situata e punësimit sipas gjinisë (2021)                                            | 40 |
| Grafiku 37 - Punësimi i mëparshëm (2021)                                                         | 41 |
| Grafiku 38 - Arsyet kryesore e ndjekjes së kursit për vitin 2019 dhe 2021                        | 41 |
| Grafiku 39 - Institucioni arsimor i studimit (2021)                                              | 42 |
| Grafiku 40 - Lloji i institucionit arsimor (2021)                                                | 42 |

|                                                                                  |    |
|----------------------------------------------------------------------------------|----|
| Grafiku 41 - Lidhja e studimeve me kursin (2021)                                 | 43 |
| Grafiku 42 - Arsyet e zgjedhjes së kursit për vitin 2019 dhe 2021                | 44 |
| Grafiku 43 - Rizgjedhja e kursit për vitin 2019 dhe 2021                         | 44 |
| Grafiku 44 - Rizgjedhja e kursit sipas qendrave (2021)                           | 45 |
| Grafiku 45 - Vlerësimi i kursit të formimit profesional (2021)                   | 46 |
| Grafiku 46 - Vlerësimi i kursit të formimit profesional (2019)                   | 46 |
| Grafiku 47 - Orientimi dhe këshillimi për të gjetur punë për vitin 2019 dhe 2021 | 47 |
| Grafiku 48 - Arritjet brenda dy viteve të ardhshme (2021)                        | 48 |
| Grafiku 49 - Arritjet brenda dy viteve të ardhshme sipas gjinisë (2021)          | 48 |

## Lista me akronimet

|       |                                                           |
|-------|-----------------------------------------------------------|
| AFP   | Arsimi dhe Formimi Profesional                            |
| AKPA  | Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive               |
| IoAFP | Institucionet Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional |
| S4J   | Projekti 'Aftësi për Punë'                                |

# 1. HYRJE

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit apo të certifikuarit e një institucioni arsimor apo të formimit profesional, realizohet nëpërmjet ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit/certifikuarit pasi diplomohen/certifikohen. Gjurmimi i të diplomuarve është një praktikë e konsoliduar dhe standarde në sektorin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Evropë. Të dhënat nga studimet gjurmuese, përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi relevancën e ofertës për kualifikime, duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe pajisjen e nxënësve apo kursantëve me njohuritë dhe aftësitë e duhura (shiko, për shembull, Schomburg, 2016)<sup>1</sup>.

Në Shqipëri, ndryshimet në vitet e fundit në kuadrin rregullator dhe të politikave, kanë filluar të zëvendësojnë praktikad ad hoc të gjurmimit me praktika sistematike dhe standarde, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel institucioni arsimor apo ofruesi. Në nivelin e politikave, në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, ngritja e një sistemi gjurmimi me ndjeshmëri për çështjet gjinore për të diplomuarit nga AFP-ja (nga kualifikimi bazë dhe më tej), u listua si objektiv nën Përparësinë Strategjike të Fuqizimit të qeverisjes së tregut të punës dhe sistemeve të kualifikimit.<sup>2</sup> Në përputhje me ligjin nr. 15/2017 ‘Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë’ dhe VKM-në nr. 554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, është institucionalizuar gjurmimi në nivel kombëtar me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), përgjegjëse për kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së. Ndërkohë, institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP), janë përgjegjëse nëpërmjet Njesisë së zhvillimit për gjurmimin në nivel ofruesi.

Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të AFP-së në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve. Ato përfaqësojnë një nga burimet e rëndësishme për vlerësimin dhe mbështetjen në përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së AFP-së me tregun e punës. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor, nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Në këtë kuadër, AKPA-ja me mbështetjen e projektit Skills for Jobs (S4J) ndërmoni gjurmimin në nivel kombëtar të të certifikuarve të vitit 2021 nga 10 qendrat e formimit profesional me qëllimin e përgjithshëm të monitorimit të treguesve kryesorë të tregut të punës për të certifikuarit nga sistemi i AFP-së.



1 Marrë nga: <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/carrying-out-tracer-studies-guide-anticipating-and-matching>

2 Objektiv D3.2. Marrë nga: [https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Punesim\\_dhe\\_Aftesi\\_Plani\\_Vepremit.pdf](https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Vepremit.pdf)



Objektivat specifike të gjurmimit në nivel kombëtar mund të përmbledhen si më poshtë:

- Vlerësimi i statusit të përgjithshëm të punësimit të të certifikuarve;
- Vlerësimi i diferencave në statusin e punësimit sipas gjinisë, grupmoshës, apo qendrës së formimit;
- Identifikimi i treguesve specifikë rreth integritetit në tregun e punës për të certifikuarit pas mbarimit të kursit, si koha mesatare në gjetjen e punës, mënyrat e gjetjes së punës, profili i punës etj.
- Analizimi i të certifikuarve të punësuar në lidhje me tipare si rëndësia e kursit me vendin e punës, paga, kushtet e punës etj.
- Analizimi i të certifikuarve që nuk janë ekonomikisht aktivë pas mbarimit të kursit;
- Vlerësimi i institucioneve ofruese bazuar në perceptimin retrospektiv të të certifikuarve;
- Knijimi i një baze të dhënash knahasimore për studimet dhe analizat e mëtejshme gjurmuese në nivel kombëtar për të krijuar një standard në këtë drejtim.

3981 të certifikuar nga 7387 të certifikuar në total nga 10 qendra të formimit profesional, iu pëngjigjën sondazhit të gjurmimit gjatë periudhës prill-qershor 2022. Ky raport përshkruan dhe analizon të dhënat dhe rezultatet e përgjithshme për rrugëtimin profesional të të certifikuarve pas mbarimit të kursit, integritetin e tyre në tregun e punës, si dhe aspekte të tjera që mund të ndihmojnë drejt vlerësimit të orientimit drejt tregut të sistemit të AFP-së në Shqipëri. Rezultatet kryesore janë paraqitur në përputhje me objektivat e studimit të gjurmimit.

Raporti është strukturuar sa më poshtë. Seksioni në vijim përshkruan metodologjinë e ndjekur për gjurmimin kombëtar. Më tej analizohen në detaj rezultatet për a) kategorinë e të certifikuarve të punësuar, b) të certifikuarve që punojnë dhe ndjekin kualifikime të mëtejshme në të njëjtën kohë, c) të certifikuarve të vetëpunësuar, d) të certifikuarve të papunë, e) të certifikuarve joaktivë, si dhe f) perceptimet mbi vlerësimin e qendrave bazuar në vlerësimin retrospektiv të të certifikuarve. Në seksionin përmbyllës jepen rezultatet e përgjithshme dhe rekomandimet kryesore.

## 2. METODOLOGJIA

### Qasja metodologjike

Për studimin e gjurmimit kombëtar të kursantëve të certifikuar, u përdor një model hulumtimi i tërthortë, ku të dhënat u mbledhën nëpërmjet pyetësorëve të standardizuar. Procesi filloi gjatë muajit shkurt 2022 me rishikimin e pyetësorit, trajnimin e anketuesve dhe mbledhjen e të dhënave me anë të telefonatave. Popullata, e cila u mor në studim, janë personat e certifikuar në 10 qendrat profesionale gjatë vitit 2021. Informacioni i mbledhur merret pas certifikimit, me qëllim që të studiohet nëse kursantët e certifikuar kanë arritur të përfshihen në tregun e punës, nëse kanë qenë të papunë ose nëse kanë arritur të kenë një rritje nga ana profesionale pas mbarimit të kursit.

Ky nuk është studimi i parë që kryhet për këtë grup të synuar. Para vitit 2021, këto studime janë realizuar duke përdorur një kampion në bazë të numrit total të të certifikuarve. Në vitin 2021, duke marrë parasysh nevojat për të gjeneruar tregues të disagreguar në nivel: qendre, grupi social, kursi etj., u realizua census-i i popullatës në vend të përzgjedhjes së një kampioni nga tërësia e popullatës. Në fund të procesit, informacioni i mbledhur mbuloi vetëm 31% të totalit. Pjesa më e madhe si pasojë e kontakteve të gabuara, ndërsa një pjesë tepër e vogël, si pasojë e refuzimit.

Për vitin 2022, duke pasur parasysh eksperiencën e vitit të kaluar, fillimisht, u realizua një pilotim demografik për të kuptuar nivelin e përgjigjeve. Në bazë të kësaj, do të merrej vendimi nëse do të ribëhej përsëri census apo do të shkohej me një kampion. Gjatë pilotimit demografik, niveli i përgjigjeve ishte 53%. Në bazë të këtij rezultati, u mor vendimi që të kryhet përsëri një census në mënyrë që të merret një informacion i plotë dhe që çdo i certifikuar të ketë të njëjtën mundësi pjesëmarrjeje në studim dhe për të pasur të dhëna sa më të sakta statistikisht, si në nivel kombëtar, ashtu edhe sipas qendrave.

Për kontaktin e të certifikuarve, u përdor baza e të dhënave të disponueshme, e siguruar nga AKPA. Popullata përfshinte 7837 persona që kishin mbaruar kurset gjatë vitit 2021. 50.7% e të certifikuarve në vitin 2021, u anketuan pas certifikimit të tyre.

### Instrumenti i studimit - pyetësori

Të dhënat për studimin e gjurmimit u bazuan në një pyetësor të standardizuar të organizuar me blloqe kryesore pyetjesh, ashtu si dhe gjatë vitit 2021.

Duke pasur parasysh eksperiencën e vitit të kaluar, në pyetësor u bënë disa nishikime, si në lidhje me përmbajtjen, ashtu edhe me mënyrën e organizimit. Megjithatë, është patur parasysh që, ndryshimet e bëra të ishin të tilla që të lejohej krahasimi me të dhënat e përfutuara një vit më parë.

Duke u nisur nga fakti se qëllimi kryesor i pyetësorit ishte studimi i përfshirjes së kursantëve të certifikuar në tregun e punës, pyetja më kryesore ishte statusi i punësimit të të anketuarve në momentin e anketimit.

Grupet në të cilat ndaheshin të anketuarit ishin:

- të punësuar (të punësuar, studentë që punonin dhe studionin në të njëjtën kohë)
- të vetëpunësuar
- të papunë aktivë
- joaktivë (studentë, shtëpiakë, të dekurajuar, PAK)

Secili nga grupet kishte bllokun e pyetjeve korrespondente sipas karakteristikave përkatëse.

Disa nga pyetjet për grupin e parë dhe të dytë (të certifikuarit në marrëdhënie pune) ishin:

- koha e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- mënyra e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- përputhja e kursit me vendin e punës
- intervali i pagës
- dobia e njohurive të marra në kurs në vendin e punës
- siguria dhe kënaqshmëria me vendin e punës

Për grupin e tretë ose të papunët:

- perceptimi mbi statusin
- roli i zyrave të punës për të gjetur punë

Për grupin e fundit ose të diplomuarit ekonomikisht joaktivë, rëndësi të veçantë kishin të dekurajuarit. Për të dekurajuarit, qëllimi ishte të merrej informacion pse ata nuk e mendonin veten të aftë për të gjetur një punë.

Për të gjithë të anketuarit pavarësisht statusit të punësimit, u drejtua një grup i njëjtë pyetjesh mbi:

- nevojën për përmirësime në aspekte të veçanta në shkollë
- perspektivën e tyre për të ardhmen profesionale.

Ashtu si dhe në anketimin e mëparshëm, u përdorën intervistat telefonike, me anë të një teknike të njohur si CATI (Computer-assisted telephone interviewing), në të cilën intervistuesi telefonon të anketuarin dhe regjistron përgjigjet e tij në një aplikacion kompjuterik, i cili administrohet online nëpërmjet përdorimit të Platformës Kobo Toolbox<sup>3</sup>.



3 <https://www.kobotoolbox.org/>

Për administrimin e pyetësonit për kursantët e certifikuar, u angazhuan 8 persona, të cilët u trajnuan nga eksperti i metodologjisë për mënyrën e duhur të administrimit. Bazuar në të dhënat e mbledhura në raundin e mëparshëm të anketës së gjurmimit, u përlllogarit se, koha mesatare që i duhej një anketuesi për të përfunduar një pyetësor, ishte 8-10 minuta.

### **Analizimi i të dhënave**

Pas mbledhjes së të dhënave, u realizua pastrimi, tabulimi dhe analizimi i tyre, duke përdorur programin statistikor SPSS. Tabulimi dhe analiza përfshijnë:

- përshkrimin deskriptiv të të dhënave nëpërmjet tabelave dhe grafikëve të ndryshëm.
- krahasimin me brezin e mëparshëm të gjurmuar.

Analiza është kryer për të gjitha pyetjet, të ndara sipas gjinisë, qendrës, si dhe statusit të punësimit.

### **Kufizimet metodologjike**

Bazuar në faktin që anketa duhej të ishte census, të dhënat duhet të merreshin për të tërë popullatën, por vetëm 50.7% e të certifikuarve në vitin 2021 arritën të intervistoheshin. Kjo përqindje përgjigjesh, vjen kryesisht si pasojë e kontakteve të paplota dhe të gabuara të gjendura në databazën e popullatës, si dhe mungesa e një kulture në lidhje me rëndësinë e anketimeve nga ana e të intervistuarve. Me gjithë kufizimet në kontaktimin e të gjithë të certifikuarve, të dhënat e mbledhura janë të mjaftueshme për kryerjen e analizave të sakta dhe nxjerrjen e konkluzioneve përfaqësuese për popullatën, siç tregohet dhe në seksionin më poshtë.

Pas kryerjes së këtij studimi, do të bëhet e mundur ndarja e të dhënave sipas grupeve të interesit, duke lejuar në të ardhmen kryerjen e studimeve të tjera, bazuar te kampionimi sipas grupeve të interesit për kërkime të ndryshme.

### 3. PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË

Bazuar në të dhënat e mbledhura, më poshtë është analiza demografike rreth shpërndarjes së të intervistuarve. Tabela 1 përmbledh shpërndarjen e të certifikuarve sipas gjinisë.

**Tabela 1 - Shpërndarja sipas gjinisë**

| Gjinia  | Të certifikuar | %    | Të anketuar | %    |
|---------|----------------|------|-------------|------|
| Femra   | 3584           | 45.7 | 2265        | 43.1 |
| Meshkuj | 4253           | 54.3 | 1715        | 56.9 |
| Totali  | 7837           | 100  | 3981        | 100  |

Për sa i përket përbërjes gjinore të popullatës, popullata për brezin e të certifikuarve në vitin 2021, përbëhet nga 45.7% femra dhe 54.3% meshkuj. Kjo përqindje është ruajtur edhe në rezultatet e të anketuarve, ku rezulton se 56.9% e tyre janë meshkuj, duke siguruar një përfaqësim të të dhënave të mbledhura në nivel gjinie.

Për sa i përket raportit të të anketuarve kundrejt numrit të të certifikuarve, rezulton se ky raport është më i lartë në vitin 2021, ku 50.8% e të certifikuarve kanë marrë pjesë në pyetësonin e gjurmimit në nivel kombëtar të të certifikuarve nga qendrat e formimit profesional për vitin 2021. Ndërkohë që në lidhje me gjurmimin e këtyre të dhënave për vitin 2019, rezulton se vetëm 31.1% e të certifikuarve kanë qenë pjesë e këtij pyetësoni.

Për të analizuar performancën e qendrave, shikohet fillimisht përfaqësimi i tyre në të dhënat e mbledhura, përmbledhur në tabelën 2. Nga të dhënat e mbledhura, rezulton se të gjitha qendrat e trajnimit janë përfaqësuese në nivel të pranueshëm. Si rrjedhojë, çdo analizë mbi performancën e qendrave është përfaqësuese për to.

**Tabela 2 - Shpërndarja sipas Qendrave Profesionale**

| DRFPP             | Të certifikuar | %    | Të anketuar | %    |
|-------------------|----------------|------|-------------|------|
| DRFPP Durrës      | 1270           | 16.2 | 545         | 13.8 |
| DRFPP Elbasan     | 802            | 10.2 | 744         | 18.8 |
| DRFPP Fier        | 639            | 8.1  | 371         | 9.4  |
| DRFPP Gjirokastrë | 548            | 7.0  | 173         | 4.4  |
| DRFPP Korçë       | 612            | 7.8  | 292         | 7.4  |
| DRFPP Nr.1 Tiranë | 1113           | 14.2 | 562         | 14.2 |
| DRFPP Nr.4 Tiranë | 1197           | 15.3 | 571         | 14.5 |
| DRFPP Shkodër     | 372            | 4.8  | 207         | 5.2  |

| DRFPP              | Të certifikuar | %     | Të anketuar | %     |
|--------------------|----------------|-------|-------------|-------|
| DRFPP Vlorë        | 908            | 11.6  | 350         | 8.9   |
| Qendra e Lëvizshme | 376            | 4.8   | 133         | 3.4   |
| Total              | 7837           | 100.0 | 3948        | 100.0 |

\*33 të anketuar nuk kanë deklaruar qendrën profesionale ku janë certifikuar





## 4. REZULTATET

Ky kapitull synon të përshkruajë dhe të analizojë rezultatet e tregut të punës të të certifikuarve në Qendrat e Formimit Profesional në vitin 2021. Kapitulli do të analizojë statusin e kursantëve që kanë përfunduar me sukses kurset profesionale. Seksionet 1 dhe 2 do të përfshijnë gjetjet mbi pjesëmarrjen në forcat e punës, statusin e punësimit, si dhe do të analizojnë faktorët që ndikojnë në punësim pas përfundimit të këtyre kurseve. Seksioni 3 fokusohet tek analiza e të dhënave të të vetëpunësuarve, i ndjekur nga seksioni 4 dhe 5 me të papunët dhe joaktivët. Analiza e performancës së kursit, pasqyrohet në seksionin 6. Njëkohësisht, ky kapitull do të përfshijë analiza krahasuese me të certifikuarit në vitin 2019, e cila do të ndihmojë për më shumë detaje rreth ecurisë së tregut të punës.

## 4.1 SITUATA E PUNËSIMIT TË TË CERTIFIKUARVE

### Situata aktuale e punësimit

Në grafikun 1 pasqyrohet shpërndarja e të anketuarve sipas statusit të punësimit. Përqindjen më të madhe të të certifikuarve në vitin 2021, e zënë të punësuarit.


(1) **Të punësuarit** përfshijnë tre kategori: të punësuar 43.7%, të vetëpunësuar 14.4% dhe ata që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë 0.7%. Nga të anketuarit, kemi gjithsej 58.8% të punësuar për vitin 2021 dhe 48.4% për vitin 2019.

(2) **Të papunët** janë ata persona që kanë mbaruar kursin dhe janë në kërkim aktiv të punës. Për vitin 2021, kjo kategori është 20.3%, ndërsa për vitin 2019, 31.8%.

(3) Kategoria e tretë janë **joaktivët** ku përfshihen: të papunët e dekurajuar (13.1%), ata që janë në ndjekje të një kualifikimi të mëtejshëm (5.4%), ata që janë duke përmbushur detyrat shtëpiake (0.5%) si dhe pjesa tjetër të deklaruar si të paafte përkohësisht ose tjetër (pensionistë etj).

Nëse do të krahasojmë shkallën e punësimit për të certifikuarit e vitit 2021 me shkallën e punësimit të marrë nga anketa kombëtare e gjurmimit për të certifikuarit e vitit 2019, rezulton se shkalla e punësimit është më e lartë: 58.8% në krahasim me 48.4%.

**Grafiku 1 - Statusi i punësimit sipas kategorive për vitin 2019 dhe 2021 (%)**



Shënim: Rezultatet në raport janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%.

Tabela 3 paraqet statusin e punësimit sipas qendrave. Përqindjen më të lartë të të punësuarve e kanë qendrat Nr. 4 Tiranë, Durrës dhe ajo Nr. 1 Tiranë (69.4%, 67.5% dhe 66.7%). Për Tiranën të dhënat janë lehtësisht të interpretueshme, pasi gjetja e një pune në kryeqytet, është më e lehtë se në qarqet e tjera. E njëjta situatë është edhe në Durrës, ku përqindja e të punësuarve është më e lartë, për shkak se ky qytet është një nga më të mëdhenjtë, si dhe ofron shërbime të shumta në sektorin e turizmit. Ndërkohë, për sa i përket pjesës më të madhe të të papunëve, përqindjen më të lartë me 38.3%, e kanë personat që janë certifikuar në Qendrën e Lëvizshme. Pas saj renditen qendrat e Korçës (25.0%), Gjirokastrës (21.4%), Shkodrës (21.3%), dhe Elbasanit (21%). Në lidhje me joaktivët të dhënat tregojnë që, e para që ka shifrën më të lartë, është Qendra e Lëvizshme me 33.8%. Gjithashtu, për sa i përket joaktivëve, në Qendrën Nr. 4, Tiranë, vihet re një shkallë më e ulët në krahasim me Qendrat e tjera, me një vlerë rreth 11.0%, që tregon një përfshirje më të gjerë në lidhje me tregun e punës.

**Tabela 3 - Statusi i punësimit sipas qendrave për vitin 2021 (%)**

| Statusi i Punësimit | Të Punësuar | Pa punë dhe po kërkoj për punë | Joaktivë | Pa Informacion |
|---------------------|-------------|--------------------------------|----------|----------------|
| DRFPP Durrës        | 67.5        | 16.1                           | 15.7     | 0.6            |
| DRFPP Elbasan       | 50.8        | 21                             | 23.4     | 4.8            |
| DRFPP Fier          | 57.1        | 19.7                           | 21.9     | 1.3            |
| DRFPP Gjirokastrë   | 54.9        | 21.4                           | 23.7     |                |
| DRFPP Korçë         | 54.1        | 25                             | 19.9     | 1              |
| DRFPP Nr. 1 Tiranë  | 66.7        | 16.7                           | 16       | 0.5            |
| DRFPP Nr. 4 Tiranë  | 69.4        | 19.6                           | 10.8     | 0.2            |
| DRFPP Shkodër       | 52.2        | 21.3                           | 23.7     | 2.9            |
| DRFPP Vlorë         | 55.1        | 20.6                           | 23.4     | 0.9            |
| Qendra e Lëvizshme  | 27.8        | 38.3                           | 33,8     |                |

Nëse do të krahasojmë shkallën të punësuarve në nivel qendrash për të certifikuarit e vitit 2021 (tabela 3) me ata të vitit 2019 (tabela 4), rezulton se shkalla të punësuarve është rritur për të gjitha qendrat. Ndërkohë që për kategorinë “pa punë dhe në kërkim të një pune”, Qendra e Lëvizshme është rritur nga 28.1% (2019) në 38.3% (2021). Për sa i përket kategorisë së tretë, joaktivëve, katër qendra kanë treguar rritje nga viti 2019 në vitin 2021 në përqindjen e të certifikuarve, përkatësisht qendra e Elbasanit nga 12.5% në 28.2%, qendra e Gjirokastrës nga 13.5% në 23.7%, qendra e Korçës nga 12.1% në 20.9%, qendra e Shkodrës nga 17.9% në 26.6%.

**Tabela 4 - Statusi i punësimit sipas qendrave për vitin 2019 (%)**

| Statusi i Punësimit | Të Punësuar | Pa punë dhe po kërkoj për punë | Joaktivë | Pa Informacion |
|---------------------|-------------|--------------------------------|----------|----------------|
| DRFPP Durrës        | 47.6        | 23.8                           | 27.6     | 1              |
| DRFPP Elbasan       | 40.3        | 43.4                           | 12.5     | 3.8            |
| DRFPP Fier          | 46.9        | 29.6                           | 23.6     |                |
| DRFPP Gjirokastrë   | 52.8        | 33.7                           | 13.5     |                |
| DRFPP Korçë         | 26.9        | 61                             | 12.1     |                |
| DRFPP Nr. 1 Tiranë  | 56.4        | 20                             | 23.2     | 0.4            |
| DRFPP Nr. 4 Tiranë  | 60.7        | 21.8                           | 17       | 0.5            |
| DRFPP Shkodër       | 38.7        | 43.1                           | 17.9     | 0.4            |
| DRFPP Vlorë         | 47.6        | 22.8                           | 23.7     | 5.8            |
| Qendra e Lëvizshme  | 17          | 28.1                           | 54.9     |                |

Një aspekt tjetër i rëndësishëm, është kombinimi i të dhënave midis statusit të punësimit dhe gjinisë, të paraqitura në tabelën 5. Nga të dhënat shikohet qartë që ka dallim të shprehshëm të statusit të punësimit sipas gjinisë. Përqindja e të punësuarve (që përfshijnë kategoritë: i/e punësuar, i/e vetëpunësuar, si dhe punoj dhe studioj) për vitin 2021 për meshkujt, është 65.8% dhe 49.5% për femrat, kundrejt 51.9% meshkuj dhe 39.1% femra në vitin 2019 (grafiku 2). Përqindja e të papunëve është më e lartë për femrat (23.3%) kundrejt meshkujve (18.0%), ndërkohë që femrat janë më të prirura për të ndjekur një shkollim të mëtejshëm apo për t'u marrë me detyra shtëpiake në krahasim me meshkujt. 7.2% e femrave ndjekin shkollën në krahasim me 4.0% të meshkujve, ndërsa 1.2% kryejnë detyra shtëpiake kundrejt 0.0% të meshkujve.

Ndërkohë që bazuar në të dhënat e vlerësimet të Anketës së Forcave të Punës, të publikuar nga INSTAT-i, gjatë vitit 2021, femrat përbëjnë 44.6% të forcës së punës dhe meshkujt 55.4%. Ashtu siç kanë rezultuar edhe të dhënat e anketimit të gjurmimit kombëtar të të certifikuarve, edhe sipas të dhënave të INSTAT-it, kategoria e të punësuarve përbëhet nga 44.5% femra dhe 55.5% meshkuj. Ndërsa në lidhje me numrin e të papunëve, 45.5% janë femra dhe 54.5% janë meshkuj, ndryshe nga rezultatet e anketimit të gjurmimit kombëtar të të certifikuarve<sup>4</sup>.




4 INSTAT (2022), Tregu i Punës 2021, <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsi/publikimet/2022/njoftim-p%C3%ABr-media-tregu-i-pun%C3%ABs-2021/>

**Tabela 5 - Situata e punësimit sipas gjinisë (2021)**

| Statusi i punësimit                                  | GJINIA |       |
|------------------------------------------------------|--------|-------|
|                                                      | F      | M     |
| I/E punësuar                                         | 39.3%  | 47.0% |
| I/E vetëpunësuar                                     | 9.2%   | 18.3% |
| Punoj dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë | 1.0%   | 0.5%  |
| Pa punë dhe po kërkoj për punë                       | 23.3%  | 18.0% |
| Pa punë, por nuk kërkoj për punë                     | 17.3%  | 10.0% |
| Student/Kursant në trajnim të mëtejshëm              | 7.2%   | 4.0%  |
| Në paaftësi të përhershme                            | 0.4%   | 0.3%  |
| Duke përmbushur detyrat shtëpiake (shtëpiak/e)       | 1.2%   |       |
| Tjetër                                               | 1.1%   | 1.9%  |
| Të padeklaruar                                       |        |       |

Grafiku 2 jep detaje krahasuese në lidhje me shpërndarjen e statusit të punësimit sipas gjinisë. Për të dy vitet, 2019 dhe 2021, përqindja e të punësuarve dominohet nga meshkujt, ndërkohë që kategoria joaktive dominohet nga femrat. Për sa i përket përqindjes së të papunëve, nëse në vitin 2019 kemi një përqindje të barabartë ndërmjet femrave dhe meshkujve, në vitin 2021, femrat dominojnë me 5.5% më shumë se meshkujt.

**Grafiku 2- Situata e punësimit sipas gjinisë (2019-2021)**



\*1.2% e të anketuarve nuk kanë deklaruar gjininë

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur rezultatet e punësimit sipas statusit etnik për të analizuar përshtatjen e tyre në tregun e punës. Për sa i përket përqindjes së punësimit, minoriteti egjiptian dhe rom, paraqesin përqindjen më të ulët të të punësuarve (43.6% dhe 46.2%, shifër që mbledh “të punësuarit”, “të vetëpunësuarit”,

dhe“ata që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë”), në krahasim me totalin e të certifikuarve, ku të punësuarit janë rreth 58.8%. Ndërkohë që në krahasim me totalin, ku të papunët paraqesin 20.3%, egjiptianët dhe romët përsëri paraqesin një përqindje të lartë të të papunëve, përkatësisht 33.3% dhe 30.8%.

**Tabela 6 - Situata e punësimit sipas statusit etnik**

|                                                                | Jo    | Rom   | Egjiptian | Total |
|----------------------------------------------------------------|-------|-------|-----------|-------|
| I/E punësuar                                                   | 43.9% | 38.5% | 30.8%     | 43.7% |
| I/E vetëpunësuar                                               | 14.5% |       | 12.8%     | 14.4% |
| Punoj (me pagë) dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë | 0.7%  | 7.7%  |           | 0.7%  |
| Pa punë dhe po kërkoj për punë                                 | 20.1% | 30.8% | 33.3%     | 20.3% |
| Pa punë, por nuk kërkoj për punë                               | 13.1% | 7.7%  | 20.5%     | 13.1% |
| Student/Kursant në trajnim të mëtejshëm                        | 5.4%  | 7.7%  |           | 5.4%  |
| Në paaftësi të përhershme                                      | 0.3%  |       | 2.6%      | 0.3%  |
| Duke përmbushur detyrat shtëpiake (shtëpiak/e)                 | 0.5%  |       |           | 0.5%  |
| Tjetër                                                         | 1.5%  | 7.7%  |           | 1.5%  |

Në shtojcën në fund të raportit paraqitet gjithashtu shpërndarja e statusit të punësimit sipas kursit të përfunduar.

## 4.2 TË CERTIFIKUARIT E PUNËSUAR


Në këtë seksion paraqiten rezultatet e gjurmimit për kategorinë e të certifikuarve që kanë deklaruar se punojnë ose që ndjekin kualifikime dhe punojnë njëkohësisht, duke përshtetur përvojën e tyre gjatë tranzicionit dhe integritit në tregun e punës. Të dhënat kryesisht paraqiten në total. Më shumë detaje për të dhënat sipas qendrave, gjenden në shtojcën në fund të raportit.

### Integrimi në tregun e punës – karakteristikat kryesore në punën aktuale

Në grafikun 3 paraqiten të dhënat e kohëzgjatjes në punën aktuale, ku rezulton se 50.8% kanë më shumë se 12 muaj në punën e tyre aktuale.




**Grafiku 3 - Kohëzgjatja në punë (2021)**



Mënyra e gjetjes së punës, është tregues i rëndësishëm për performancën e qendrave profesionale. Sipas të dhënave, 56% kanë arritur të gjejnë punë falë njohjeve dhe lidhjeve familjare. Vetëm 2.7% e të intervistuarve kanë deklaruar se kanë gjetur punë nëpërmjet zyrës së punës. Ndiham që u jep qendra e formimit, duket mjaft e kufizuar, duke shënuar edhe një rënie në krahasim me vitin 2019, ku 6.3% e të anketuave shprehen se gjetën punë nëpërmjet zyrës së punës. Ndaj shihet primare nevoja që zyra e punës të jetë më aktive në orientimin dhe këshillimin për punësim të kursantëve gjatë kursit, dhe sigurisht pas përfundimit të tij.


**Grafiku 4 - Mënyra e gjetjes së punës (2021)**



Ndaj pyetjes nëse individët e certifikuar punojnë në të njëjtin vend pune ose jo, 56.6% deklarojnë se janë në të njëjtën punë përpara se ata të fillojnë kursin. Ndërkohë që, në vitin 2019, një përqindje më e lartë e të certifikuarve deklaroi se janë në po të njëjtën punë, specifikisht 64.5% e tyre. Këto të dhëna mbështesin edhe njëherë vlerat e deklaruar nga të anketuarit, ku 50.1% kishin më shumë se një vit të punësuar në punën aktuale.




**Grafiku 5 - Punësimi në të njëjtin vend për vitin 2019 dhe 2021**




Në grafikun e mëposhtëm, paraqiten të dhënat sipas llojit të punës. Nëse në vitin 2019, 91.9% e të certifikuarve punonin me kohë të plotë, në vitin 2021 punësimi me kohë të plotë ka pësuar një rënie të lehtë, ku rreth 85.6% deklarojnë të kenë një kontratë me kohë të plotë. Pjesa tjetër e të punësuarve kanë një punë me kohë të pjesshme.

**Grafiku 6 - Lloji i punësimit për vitin 2019 dhe 2021**




Grafiku 7 jep një informacion më të detajuar në lidhje me llojin e punësimit sipas gjinisë. Në vitin 2021, 16.9% e femrave deklarojnë të kenë një kontratë pune të pjesshme, ndërkohë që për meshkujt, kjo shifër është disi më e ulët, rreth 12.9%.

**Grafiku 7 - Lloji i punësimit sipas gjinisë (2021)**




Në lidhje me madhësinë e subjektit ku punojnë, për të certifikuarit në vitin 2021 rezulton se 54.3% punojnë në subjekt të mesëm ose të madh, subjekt me më shumë se 10 punonjës, ndërsa për vitin 2019, kjo shifër rezulton të jetë disi më e lartë prej rreth 58.4%.

**Grafiku 8 - Madhësia e subjektit (2021)**




**Grafiku 9 - Madhësia e subjektit (2019)**




Në lidhje me llojin e kontratës, për të anketuarit e vitit 2021, 50.2% kanë një kontratë pa afat, përkundrajt 26.4% që punojnë pa kontratë pune. Ndërkohë që, për të anketuarit e vitit 2019, 53.4% kanë një kontratë pa afat, përkundrajt 20.4% që punojnë pa kontratë pune. Pra, nga viti 2019 në vitin 2021, kemi një rritje prej rreth 6% të të punësuarve pa kontratë.

**Grafiku 10 - Kontrata e punës për vitin 2019 dhe 2021**




Të pyetur sa të sigurt apo të stabilizuar ndihen në punën e tyre aktuale, vetëm 55.6% kanë shprehur siguri dhe stabilitet. Kjo tregon se megjithëse 72.8% kanë një kontratë pune, përsëri, vetëm rreth 50.6% ndihen të sigurt dhe të stabilizuar në atë vend pune.

**Grafiku 11 - Qëndrueshmëria në punën aktuale (2021)**



Nëse do të krahasojmë femrat me meshkujt, meshkujt paraqesin pjesën e shoqërisë më të pasigurt në punën aktuale, ku për vitin 2021, 18.6% e tyre kanë deklaruar se ata janë “shumë të pasigurt” ose “të pasigurt”, kundrejt 15.8% e femrave.


**Grafiku 12 - Qëndrueshmëria në punën aktuale sipas gjinisë (2021)**



### Integrimi në tregun e punës – të ardhurat


Në lidhje me shpërndarjen e të ardhurave, nga përqindja e të punësuarve (që përfshin kategoritë: i punësuar, i vetëpunësuar, si dhe punoj dhe studioj), 26.2% kanë deklaruar të ardhura deri në 32.000 lekë, që korrespondon me pagën minimale në vend. 2.8 % e të certifikuarve kanë deklaruar një pagë mbi 95.000 lekë.

**Grafiku 13 - Të ardhurat mujore nga puna (2021)**




Ndërkohë që për vitin 2019, nga përqindja e të punësuarve, 22% kanë deklaruar të ardhura deri në 30.000 lekë, një përqindje jo shumë e ndryshme nga ajo e vitit 2021 (26.2%), duke marrë parasysh që për vitin 2021, kemi të dhëna për pagën deri në 32.000 lekë. Për sa i përket të certifikuarve që kanë deklaruar një pagë mbi 95.000 lekë, viti 2021 ka një përqindje më të ulët (2.8%), në krahasim me vitin 2019 (5.3%).

**Grafiku 14 - Të ardhurat mujore nga puna (2019)**




Grafiku 15 paraqet diferencën e pagave sipas gjinisë. Rezulton se ka një diferencë në paga bazuar te gjinia. Femrat janë më pak të paguara sesa meshkujt. 66.7% e femrave rezultojnë me një pagë deri në 40.000 lekë, përkundrejt 42.1% të meshkujve. Në vitin 2019, ky raport ishte 55.1% me 42.9%. Në kategoritë e tjera të pagave, meshkujt zënë përqindjen më të madhe. Pagat mbi 95.000 lekë, i sigurojnë vetëm 1.0 % e femrave përkundrejt 3.9% të meshkujve, ndërsa në vitin 2019, ky raport ishte 0.2% me 1.1%. Pra, shihet qartë se, niveli i pagave, ka pasur një rritje të lehtë në vitin 2021.

**Grafiku 15 - Shpërndarja e të ardhurave sipas gjinisë (2021)**




Referuar shpërndarjes së të ardhurave sipas statusit të punësimit në grafikun 16, për të certifikuarit në vitin 2021, 72.4% e personave që studiojnë dhe punojnë në të njëjtën kohë, rezultojnë me një pagë deri në 40.000 lekë. Për të certifikuarit vitin 2019 (grafiku 17), kjo shifër ishte pothuajse e njëjtë, rreth 70.3%. Shpërndarja e të ardhurave për të punësuarit dhe të vetëpunësuarit, është e ngjashme. Dallimi kryesor midis tyre, qëndron për pagat e larta mbi 95.000 lekë, ku të punësuarit zënë 1,9% ndërsa të vetëpunësuarit 5,7% (në vitin 2021) dhe në vitin 2019, të punësuarit zënë 0,7%, ndërsa të vetëpunësuarit 1,4%.

**Grafiku 16 - Shpërndarja e të ardhurave sipas statusit të punësimit (2021)**




**Grafiku 17 - Shpërndarja e të ardhurave sipas statusit të punësimit (2021)**



Ndërkohë që në lidhje me rritjen e të ardhurave mbas mbarimit të kursit, nga të anketuarit e certifikuar në vitin 2021, 32.5% kanë deklaruar rritje, përkundrejt 66.2% që nuk kanë pasur ndryshim të nivelit të të ardhurave, dhe vetëm 1.2% kanë patur ulje në të ardhurat e tyre pas mbarimit të kursit të ndjekur. Niveli i të ardhurave duket në rritje në krahasim me vitin 2019, ku vetëm 28% kanë deklaruar rritje, përkundrejt 72% që nuk kanë pasur rritje të të ardhurave, specifikisht 29.9% nuk kanë deklaruar ndryshim në nivel të ardhurash, dhe 42.1% kanë deklaruar rënie të tyre.


**Grafiku 18 - Rritja e të ardhurave pas mbarimit të kursit për vitin 2019 dhe 2021**



### Integrimi në tregun e punës – përputhshmëria e trajnimit


Të certifikuarit e punësuar janë pyetur për përputhjen e trajnimit me punën e tyre. Sipas të dhënave, 49.4% e tyre kanë deklaruar se trajnimi dhe puna e tyre, kanë lidhje me njëra-tjetrën, ndërsa pjesa tjetër deklaron se, trajnimi profesional i marrë në këto qendra, nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me punën e tyre. Megjithatë me një ndryshim shumë të lehtë, mund të themi se në krahasim me vitin 2019, viti 2021 tregon që të certifikuarit kanë gjetur më shumë ngjashmëri të trajnimit me vendin e tyre aktual të punës.

**Grafiku 19 - Lidhja e kursit me punën aktuale për vitin 2019 dhe 2021**



Nëse do të krahasonim femrat dhe meshkujt, ata kanë një përqasje të njëjtë në lidhje me: b) Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me trajnimin tim; dhe c) Nuk ka oferta pune në fushën time në rajonin ku punoj. Për sa i përket gjetjes së një vendi pune në lidhje me trajnimin e kryer, femrat hasin më tepër vështirësi në këtë drejtim. 40.7% e të punësuarave femra, deklarojnë se nuk gjejnë një vend pune që ka lidhje me kursin e kryer, kundrejt 31.6% të meshkujve. Ndërkohë, meshkujt janë më tepër të prirur të zgjedhin një punë ndryshe nga ajo e trajnimit, për shkak të një page ose kushteve më të mira.


**Grafiku 20 - Arsyet e përzgjedhjes së një pune ndryshe nga ajo e trajnimit, sipas gjinisë (2021)**



Me shumë se gjysma e të certifikuarve në vitin 2021, deklarojnë që i përdorin njohuritë e marra gjatë kusit. 57.6% e tyre, thonë se i përdorin mesatarisht, ose shumë, këto njohuri. Për të certifikuarit në vitin 2019, kjo shifër ka qenë disi më e ulët, rreth 53.9%. Grafiku 21 tregon një përmirësim të njohurive të marra, duke i lidhur me përdorimin e tyre.




**Grafiku 21 - Përdorimi i njohurive në punë, për vitin 2019 dhe 2021**



Duke analizuar lidhjen e vendit të punës me njohuritë e marra në kursin e kryer, ka një ndryshim sipas statusit të punësimit. 78.2% e të vetëpunësuarve, kanë deklaruar se njohuritë e marra, lidhen me vendin e punës, përkundrajt 51.1% të të punësuarve.


**Grafiku 22 - Përdorimi i njohurive në punë aktuale, sipas situatës së punësimit (2021)**



#### 4.3 TË CERTIFIKUARIT E VETËPUNËSUAR

Në këtë seksion paraqiten rezultatet kryesore të të certifikuarve që janë të vetëpunësuar në raport me totalin e kursantëve. Në përgjithësi shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas qendrave, është e balancuar, duke variuar nga rreth 10%, deri në rreth 20%. Pjesa më e madhe e të vetëpunësuarve sipas qendrave, rezulton në Shkodër me 20.3%, ndërsa Qendra e Lëvizshme rezulton me numrin më të ulët të të vetëpunësuarve, me 10.5%.

**Grafiku 23 - Shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas qendrave (2021)**



### Lidhja e kursit me punën


78.1% e të anketuarve, deklaruan se fusha e aktivitetit të tyre, kishte lidhje me trajnimin që ata kishin kryer, kundrejt 75.2% që ishte për të certifikuarit në vitin 2019.

**Grafiku 24 - Lidhja e fushës së biznesit me trajnimin, për vitin 2019 dhe 2021**



Ndërkohë, nëse do të krahasojmë femrat me meshkujt, meshkujt paraqesin lidhjen më të lartë të vetëpunësimit me kursin e kryer, ku rreth 80% e tyre, deklarojnë që kursi ka lidhje me aktivitetin e tyre të biznesit, kundrejt 20%, të cilët megjithëse ishin pjesë e trajnimit, nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me biznesin që ata drejtonin.


**Grafiku 25 - Lidhja e fushës së biznesit me trajnimin, sipas gjinisë (2021)**



## Detaje të tjera në lidhje me sipërmarrjen


Në lidhje me kohën e hapjes së biznesit, 58.8% kanë deklaruar se e kanë hapur biznesin para kursit ndërsa 13.7% punojnë në biznes familjar. Për sa i përket përqindjes së individëve që kanë hapur biznes pak kryerjes së kursit, kjo përqindje është pothuajse e njëjtë për të certifikuarit në vitin 2021 dhe 2019, me rreth 27%.

**Grafiku 26 - Koha për hapjen e biznesit, për vitin 2019 dhe 2021)**




Për sa i përket madhësisë së biznesit, në anketën me të certifikuarit e vitit 2021, 57.2% nuk kanë asnjë të punësuar tjetër, kundrejt 48.2% për 2019. Ndërkohë që bizneset që kanë më shumë se 3 të punësuar për të dy vitet, janë rreth 10%. Pjesa tjetër, janë bizneset që kanë 1-3 persona të punësuar. Në lidhje me tipin e bizneseve, të cilat drejtohen nga të certifikuarit, në përgjithësi ato janë biznese në nivel mikro.

**Grafiku 27 - Numri i të punësuarve në biznesin privat/familjar, për vitin 2019 dhe 2021**



Në lidhje me perspektivën e vetëpunësimit, 67.5% e shohin si një aktivitet të përhershëm të tyre, përkundërt 21.8%, që e shohin si një alternativë të përkohshme, deri në një punësim në një kompani më të sigurt. Vlen për t'u përmendur fakti se, për të certifikuarit në vitin 2019, numri i të anketuarve që e shohin vetëpunësimin si një aktivitet të përhershëm të tyre, ka qenë më i lartë.


**Grafiku 28 - Perspektiva e vetëpunësimit për vitin 2019 dhe 2021**



#### 4.4 TË CERTIFIKUARIT E PAPUNË


Në këtë seksion paraqiten të dhënat e personave që janë aktivë në kërkim të një pune, të cilët janë pjesë e kategorisë së papunë. Shkalla e papunësisë në total, është 20.3%, ku përqindja më e madhe e të papunëve sipas qendrave, rezulton të jetë në qendrën e Lëvizshme me 38.3%, e ndjekur nga qendra e Korçës me 25%. Durrësi është qendra me përqindje më të ulët të papunësisë, me 16.1%.

**Grafiku 29 - Shpërndarja e të papunëve sipas qendrave (2021)**




Nëse krahasojmë papunësinë sipas gjinisë për secilën nga qendrat, shihet se numri më i madh i të papunëve, i përket femrave. Përfundimisht, bën vetëm qendra e Lëvizshme, dhe Qendra e formimit Vlorë, ku dominojnë meshkujt.

**Grafiku 30 - Shpërndarja e të papunëve sipas qendrave dhe gjinisë (2021)**



Nga të dhënat, rezulton një përqindje e lartë e personave të papunë, që nuk kanë qenë asnjëherë të punësuar që nga koha e mbarimit të kursit, përkatësisht për të certifikuarit në vitin 2021, 70.4%, dhe për vitin 2019, 74.9%.

**Grafiku 31 - Punësimi i mëparshëm për të papunët (2021)**



Arsyet kryesore pse janë larguar nga puna e fundit, paraqiten në tabelën 7. 25.7% e personave janë larguar nga puna pasi u ka mbaruar kontrata, ose si pasojë e shkurtimit të vendit të punës. Për arsye personale, janë larguar 35.9% e tyre. Kategoria për arsye të tjera ose mospërgjigje, përbën rreth 30.3%. E njëjta situatë rezulton edhe për të anketuarit e certifikuar në vitin 2019, ku 26.9% e personave janë larguar nga puna pasi u ka mbaruar kontrata, ose si pasojë e shkurtimit të vendit të punës, 37.6% janë larguar për arsye personale, dhe 31.1% për arsye të tjera ose mospërgjigje.

**Tabela 7 - Arsyet e largimit nga puna**

|                                                            | 2019     | 2021     |
|------------------------------------------------------------|----------|----------|
| <b>Arsyet e largimit nga puna</b>                          | <b>%</b> | <b>%</b> |
| Më mbaroi kontrata e punës                                 | 11.8     | 13.7     |
| Vendi i punës nuk përputhej me trajnimin tim               | 3.3      | 2.6      |
| M'u ofrua një pagë më e mirë te puna e re                  | 0.6      | 4.3      |
| Kishte shkurtime në vendin e punës                         | 15.1     | 12.0     |
| Kërkesat e punës ishin më të larta se aftësitë e zotëruara | 0.6      | 1.3      |
| Për arsye personale                                        | 37.6     | 35.9     |
| Tjetër                                                     | 31.1     | 30.3     |

### Të kërkuarit për punë

Nga të anketuarit e certifikuar në 2021, për kategorinë e të papunëve rezulton që rreth 70.4% janë në kërkim aktiv të një pune në 4 javët e fundit. Personat që kanë deklaruar se po kërkojnë për punë në 4 javët e fundit, janë pyetur në lidhje me mënyrat e kërkimit të punës.

**Tabela 8 - Mënyrat e kërkimit të punës**

|                                                                                   | 2021     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------|
| <b>Si po kërkon për punë?</b>                                                     | <b>%</b> |
| Nëpërmjet Zyrës së Punës                                                          | 19.2%    |
| Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj. | 29.8%    |
| Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve                        | 45.6%    |
| Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)         | 4.4%     |
| Tjetër                                                                            | 1.0%     |

Nga të anketuarit, 813 kanë përmendur të paktën një aspekt. 19.2% e përgjigjeve, kanë deklaruar se kanë kërkuar punë pranë zyrave të punës, dhe 45.6% e të intervistuarve kanë përzgjedhur njohjet dhe lidhjet familjare si mënyrën që përdorin për të kërkuar punë. Gjithashtu, 29.8% e të intervistuarve, kanë deklaruar si mënyrë kërkimi të punës lajmërimet e publikuara në faqe interneti, media sociale, gazeta etj. Në krahasim me vitin 2019, shohim që ka një rënie të kërkimit të punësimit nëpërmjet zyrës së punës.

Personat, të cilët nuk kanë kërkuar punë, kanë listuar arsyet e mëposhtme. Nga të anketuarit e certifikuar në vitin 2021, arsyeja kryesore që nuk kanë kërkuar punë gjatë 4 javëve të fundit është se, kujdesen për fëmijët/familjen (18.3%), kanë në plan të largohen nga vendi (15.3%), dhe nuk kanë besim se do të gjejnë një punë (14%), ndërkohë që nga të anketuarit e 2019, arsyeja kryesore për moskërkimin e punës gjatë 4 javëve të fundit është se, nuk kanë besim se do të gjejnë një punë (21%), ndërkohë që 21% presin të fillojnë punë së shpejti ose janë në pritje të sezonit të përshtatshëm.


**Tabela 9 - Arsyet që nuk kërkon punë**

|                                       | 2019 | 2021 |
|---------------------------------------|------|------|
| Arsyet që nuk kërkon punë             | %    | %    |
| Nga sëmundja ose paaftësia            | 5.2  | 5.1  |
| Kujdesem për fëmijët/familjen         | 10.9 | 18.3 |
| Po pres të filloj punë së shpejti     | 10.3 | 12.3 |
| Po pres për sezonin e përshtatshëm    | 10.7 | 5.5  |
| Nuk kam dëshirë të punoj për momentin | 5.7  | 1.7  |
| Nuk kam besim se do të gjej një punë  | 21   | 14.0 |
| Kam në plan të largohem nga vendi     | 12   | 15.3 |
| Tjetër                                | 24.2 | 27.7 |

### Marrëdhënia me zyrat e punës

Nga kategoria e të papunëve, 54% nuk janë regjistruar në zyrën e punës dhe kjo shpjegohet nga fakti se, mënyra më e zakonshme e gjetjes së punës, deklarohet nëpërmjet njohjeve familjare dhe shoqërore. E njëjta situatë figuron edhe për të anketuarit të certifikuar në vitin 2019, ku 50.1% nuk janë regjistruar në zyrën e punës.

**Grafiku 32 - Regjistrimi në zyrat e punës (2021)**



Sipas përgjigjeve të mbledhura në të dy vitet, 2019 dhe 2021, femrat tentojnë të regjistrohen në zyrat e punës më shumë se meshkujt.


**Tabela 10 - Regjistrimi në zyrat e punës sipas gjinisë**

| Regjistrimi në zyrat e punës | 2019  |       | 2021  |       |
|------------------------------|-------|-------|-------|-------|
|                              | F     | M     | F     | M     |
| Po                           | 53.5% | 41.9% | 58.3% | 51.1% |
| Jo                           | 46.5% | 58.1% | 41.7% | 48.9% |




Nga personat që janë të regjistruar në zyrat e punës, për vitin 2021, 55.4% deklarojnë se zyra e punës nuk i ndihmon në gjetjen e punës, kundrejt 58.5% në vitin 2019. Vetëm 27.2% (në vitin 2021) dhe 28.8% (në vitin 2019) ndihmohen me informacione mbi vendet e lira të punës.

**Grafiku 33 - Ndhimja e zyrave të punës (2021)**



Personat që nuk janë regjistruar paraqesin si arsye kryesore mungesën e besimit si dhe mungesën e interesit për t'u regjistruar pranë këtyre zyrave. Përqindja e këtyre personave është 59.8% për të certifikuarit në 2021 dhe 79.4% për të certifikuarit në vitin 2019. Ndërkohë që numri i personave që kanë deklaruar se nuk dinë si të regjistrohen, ka pësuar një rritje, nga 7.1% që ishte në vitin 2019, në 12.3% në vitin 2021.

**Grafiku 34 - Arsyet e mosregjistrimit për vitin 2019 dhe 2021**




## 4.5 TË CERTIFIKUARIT JOAKTIVË NË TREGUN E PUNËS

Në kategorinë e joaktivëve janë përfshirë kategoritë e mëposhtme:

- Pa punë, por nuk kërkoj për punë
- Student/Kursant në trajnim të mëtejshëm
- Tjetër (Në paaftësi të përhershme; Duke përmbushur detyrat shtëpiake (shtëpiak); Tjetër)


Nga të dhënat e të certifikuarve në vitin 2021, 63.2% e joaktivëve janë të papunë dhe nuk kërkojnë punë, përkundrajt 25.8% që janë studentë/kursantë në trajnime të mëtejshme. Ndërkohë që për të certifikuarit në vitin 2019, përqindja e e joaktivëve janë të papunë dhe nuk kërkojnë punë, ka qenë më e ulët, rreth 45%.

**Grafiku 35 - Situata e punësimit sipas kategorisë joaktivë (2021)**




Për sa i përket gjinisë, rezulton se, për dy kategoritë e joaktivëve, dominojnë femrat. Në kategorinë student/kursant, 64.1% janë femra, përkundrajt 35.9% të papunë por nuk kërkoj punë. Ndërsa në kategorinë tjetër, meshkujt zënë përqindjen më të lartë, rreth 55.1%.

**Grafiku 36 - Situata e punësimit sipas gjinisë (2021)**



74.5% e studentëve/kursantëve në trajnim të mëtejshëm nuk kanë qenë ndonjëherë të punësuar që nga koha e mbarimit të kursit. 78.2% e të papunëve dhe që nuk kërkojnë punë, nuk kanë qenë ndonjëherë të punësuar, përkundrejt 77.6% të personave që i përkasin kategorisë tjetër.


**Grafiku 37 - Punësimi i mëparshëm (2021)**



### Student/Kursant në trajnime të mëtejshme


Për të certifikuarit në vitin 2021, 40.8% që po ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë deklaruar si arsye dëshirën për të fituar një kualifikim më të lartë përkundrejt 36.5% në vitin 2019. Për sa i përket arsyes se ata ndjekin studimet për të gjetur një punë më të mirë në vitin 2021, kanë deklaruar vetëm 21.1%, ndërsa në vitin 2019, arsyeja për të gjetur një punë më të mirë është më e fortë, me rreth 42.5%. Përsëri në lidhje me arsyen për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale, në vitin 2021 është 37.1% dhe në vitin 2019, 18.2%

**Grafiku 38 - Arsyeja kryesore e ndjekjes së kursit për vitin 2019 dhe 2021**



71.8% e të certifikuarve që po vazhdojnë kualifikime të mëtejshme studiojnë në universitet, përkundrejt 5.2% që vazhdojnë një kurs në qendrat e formimit profesional.

**Grafiku 39 - Institucioni arsimor i studimit (2021)**




Nga tabela 11, rezulton se në krahasim me të certifikuarit në vitin 2019, në universitet ka një pjesëmarrje më të madhe në vitin 2022 (73.1%), ndërsa për sa u përket kurseve në qendrat e formimit profesional, ka rreth 5% për të dy vitet.

**Tabela 11 - Institucioni arsimor i studimit sipas gjinisë**

| Institucioni arsimor                            | 2019 | 2022 |
|-------------------------------------------------|------|------|
| Universitet                                     | 71.8 | 73.1 |
| Qendër e Formimit Profesional (po vazhdoj kurs) | 5.2  | 5.0  |
| Tjetër                                          | 23.0 | 21.9 |


77.6% studiojnë në institucione publike dhe vetëm 22.4% në institucione private të arsimit. Ndërkohë që, nëse krahasojmë regjistrimet e gjinive në bazë të llojit të institucionit, vihet re se meshkujt janë me numër më të lartë se femrat duke ndjekur një program/kurs të mëtejshëm në institucionet private. Specifikisht, 31.1% e meshkujve ndjek studimet në institucion privat, kundrejt 15.4% e femrave.

**Grafiku 40 - Lloji i institucionit arsimor (2021)**



Nëse për të certifikuarit në vitin 2019, 21.9% deklaruan se fusha e studimeve të tyre kishte lidhje me kursin e kryer, për të certifikuarit në vitin 2021 shohim që kjo përqindje pësoi një rritje të lehtë, rreth 25.2%.

**Grafiku 41 - Lidhja e studimeve me kursin (2021)**



Nga kategoria e të certifikuarve që ndjekin studime të mëtejshme, 29.7% e meshkujve ndiqnin të të njëjtën fushë të studimit, krahasuar me 22.1% të femrave. Ndërkohë që për të certifikuarit në vitin 2019, përqindja e femrave që ndjekin të njëjtën fushë të studimit, është më e lartë, rreth 29.9%.

**Tabela 12 - Lidhja e studimeve me kursin sipas gjinisë**


|    | 2019  |     | 2021  |       |
|----|-------|-----|-------|-------|
|    | F     | M   | F     | M     |
| Po | 29.9% | 16% | 22.1% | 29.7% |
| Jo | 70.1% | 84% | 77.9% | 70.3% |

## 4.6 VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË CERTIFIKUARVE

Në këtë seksion, paraqiten gjetjet kryesore të vlerësimit retrospektiv të të certifikuarve nga qendrat e formimit profesional për institucionin ku kanë ndjekur kursin. Nga të dhënat rezultojnë se nga të anketuarit e vitit 2021, afërsisht gjysma (49.9%) kanë zgjedhur të ndjekin një kurs profesional për të rritur kualifikimet, 17.2% kanë zgjedhur kursin për t'u promovuar në punën e tyre aktuale, 10.7% për të marrë certifikatë, dhe 6.7% për të filluar një punë diku tjetër. Ndërkohë që për vitin 2019, rezultojnë se 36.3% kanë zgjedhur të ndjekin një kurs profesional për të rritur kualifikimet, kundrejt 23.2% që kanë për qëllim fillimin e një pune tjetër. 18.4% kanë deklaruar se qëllimi i tyre ishte marrja e certifikatës në përfundim të kursit.

Në lidhje me arsyet e zgjedhjes së kursit, për anketën e vitin 2021, vëmë re se nuk ka një dallim gjinor. Për të dyja kategoritë, arsyet më dominante janë "për të rritur kualifikimet e mia": 51.2% për femrat dhe 49.4% për meshkujt, dhe "për t'u promovuar në punë": 17.2% për femrat dhe 17.5% për meshkujt. Ndërkohë që për anketën e vitin 2019, dallimi gjinor është i ndjeshëm vetëm në kategoritë për të rritur kualifikimet, si dhe për të marrë certifikatën. Femrat tentojnë të rrisin kualifikimet e tyre (40.1%), ndërsa meshkujt e ndjekin kursin për të marrë certifikatën (21.5%).

**Grafiku 42 - Arsyet e zgjedhjes së kursit për vitin 2019 dhe 2021**




**Tabela 13 - Arsyet e zgjedhjes së kursit sipas gjinisë**

| Arsyet e zgjedhjes së kursit        | 2019  |       | 2021  |       |
|-------------------------------------|-------|-------|-------|-------|
|                                     | F     | M     | F     | M     |
| Për të rritur kualifikimet e mia    | 40.1% | 33.9% | 51.2% | 49.4% |
| Për t'u promovuar në punë           | 9%    | 10.9% | 17.2% | 17.5% |
| Për një rrogë më të mirë            | 1.3%  | 0.8%  | 0.9%  | 1.3%  |
| Për të hapur një biznes timin       | 5.3%  | 5.2%  | 4.9%  | 3.8%  |
| Për të filluar një punë diku tjetër | 24%   | 22.7% | 8.9%  | 5.1%  |
| Për të marrë certifikatën           | 13.7% | 21.5% | 7.2%  | 13.4% |


Vlen për t'u theksuar fakti se në anketimet e të dy viteve, kemi një përqindje të lartë të të certifikuarve që kanë deklaruar se nëse do të kishin mundësi, do të zgjidhnin përsëri të njëjtin kurs, përkatësisht 86.2% dhe 83.3%. Nga viti në vit, kemi një rritje të lehtë me 2.9 p.p në përzgjedhjen e të njëjtit kurs.

**Grafiku 43 - Rizgjedhja e kursit për vitin 2019 dhe 2021**



Në lidhje me zgjedhjen e të njëjtit kurs, Qendra Gjirokastrë rezultoi me përqindjen më të lartë, 96.5%, e shoqëruar nga qendra DRFPP Durrës, 93.1%. Ndërsa në qendrën DRFPP Elbasan, vetëm 70.5% e të certifikuarve do të zgjidhnin të njëjtin kurs.


**Grafiku 44 - Rizgjedhja e kursit sipas qendrave (2021)**



Në pyetësor u përfshinë disa kategori pyetjesh në lidhje me nevojën për përmirësime të aspekteve të ndryshme si infrastruktura, kurrikulat, mësimdhënia, tekstet mësimore, aftësia teorike, praktika, puna në zyrën e karrierës, bashkëpunimi me biznesin etj. Pyetjet u formuluan në mënyrë të tillë që të ishin sa më të kuptueshme nga intervistuesi dhe i anketuari, duke zgjedhur përgjigjen nëpërmjet alternativave të parashikuara në pyetësor, të cilat janë të shkallëzuara sipas shkallës Likert. Gjatë fazës së përpunimit, të dhënat e të intervistuarve u grupuan në 3 shkallë: a) aspak ose pak; b) mesatarisht; si dhe c) shumë dhe jashtëzakonisht shumë.

Grafiku 45 dhe 46 japin detajet e përgjithshme në lidhje me vlerësimin e treguesve të përdorur për të matur cilësinë e kursit profesional. Për të certifikuarit në vitin 2021, aspektet si “Bashkëpunimi me zyrat e punës”, “Bashkëpunimi me bizneset”, dhe “Këshillimi i Karrierës” janë gjetur si aspektet më pak të vlerësuara nga të certifikuarit, ku përkatësisht 19%, 16.1% dhe 15.6%, kanë shprehur vlerësimin “aspak ose pak”. Duke u bazuar në këto rezultate, mund të themi se drejtuesit e qendrave të formimit duhet të kenë si prioritet përmirësimin e këtyre treguesve.


**Grafiku 45 - Vlerësimi i kursit të formimit profesional (2021)**



Për të certifikuarit në vitin 2019, aspektet më pak të vlerësuara kanë qenë “Bashkëpunimi me bizneset”, “Bashkëpunimi me zyrat e punës”, “Praktika në biznes”, dhe “Karriera”, përkatësisht me 12.7%, 11.4%, 10.7% dhe 10.2% të pakënaqur me performancën e kursit profesional.

Nga viti 2019 në vitin 2021, vihet re një përmirësim i treguesve, përveç “Bashkëpunimit me zyrat e punës”, “Bashkëpunimit me bizneset”, dhe “Këshillimit të Karrierës”, ku vlerësimi i shkallës “Aspak dhe Pak” për këta tregues është rritur përkatësisht me 7.6%, 3.4%, dhe 5.4%.

**Grafiku 46 - Vlerësimi i kursit të formimit profesional (2019)**






## Orientimi dhe këshillimi i qendrave të formimit

Të dhënat tregojnë se rreth 30% e të punësuarve kanë deklaruar se përgjithësisht nuk kanë pasur orientim dhe këshillim për punësim nga qendrat për të gjetur punë mbas mbarimit të kursit. Megjithatë, mund të thuhet se kjo situatë është përmirësuar në krahasim me të certifikuarit në vitin 2019, ku 40 % e të anketuarve deklarorin se nuk kishin pasur orientim dhe këshillim për punësim nga qendrat për të gjetur punë mbas mbarimit të kursit. Ndërkohë që krahasuar me vitin 2019, ku 30% kanë deklaruar se kanë mësuar si të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë të ndryshme, për të certifikuarit në vitin 2021 vetëm 5.4% kanë deklaruar se kanë mësuar si të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë të ndryshme. 31.5% e të certifikuarve kanë zgjedhur “Tjetër”, ku mbizotërojnë rastet (1) Kam biznesin tim; (2) Jam punësuar vetë; dhe (3) Nuk jam interesuar.

Grafiku 47 - Orientimi dhe këshillimi për të gjetur punë për vitin 2019 dhe 2021




## Pritshmëritë për dy vitet e ardhshme

Për sa i përket pritshmërive për të ardhmen, në total 52.8% e përgjigjeve janë të lidhura me punësimin, ku 15.5% e të anketuarve kanë qëllim të gjejnë një punë, 21.7% kanë qëllim të gjejnë një punë që të lidhet me fushën e studimit/trajnimit, dhe 16.6% lidhen me sipërmarrjen ku duan të fillojnë biznesin e tyre. Ndërkohë që një pjesë tjetër e të anketuarve kanë si synim ndryshimin e vendndodhjes, ku 16.6% dëshirojnë të emigrojnë jashtë vendit dhe 0.2% dëshirojnë të emigrojnë në një qytet tjetër brenda vendit. Vlen për t'u përmendur fakti se trendi për të emigruar, ka qenë pak më i lartë në vitin 2019, ku 20.8% kanë deklaruar se duan të emigrojnë jashtë vendit dhe 0.8% të lëvizin në një qytet tjetër brenda vendit. Së fundmi, 5% dëshirojnë të ndjekin studime të mëtejshme.


Ndërkohë, në dy vitet e ardhshme, femrat në krahasim me meshkujt kanë një përqindje më të lartë (1) të jenë të punësuar, (2) të gjejnë një punë që të lidhet me fushën e studimit/trajnimit, (3) të fillojnë biznesin e tyre, (4) të ndjekin studime të mëtejshme, dhe (5) të emigrojnë në një qytet tjetër brenda vendit. E vetmja alternativë që dominon nga meshkujt, është dëshira për të emigruar jashtë vendit me 21%, kundrejt femrave me 11.1%.

**Grafiku 48 - Arritjet brenda dy viteve të ardhshme (2021)**



Ndërkohë, në dy vitet e ardhshme, femrat në krahasim me meshkujt kanë një përqindje më të lartë (1) të jenë të punësuar, (2) të gjejnë një punë që të lidhet me fushën e studimit/trajnitimit, (3) të fillojnë biznesin e tyre, (4) të ndjekin studime të mëtejshme, dhe (5) të emigrojnë në një qytet tjetër brenda vendit. E vetmja alternativë që dominon nga meshkujt, është dëshira për të emigruar jashtë vendit me 21%, kundrejt femrave me 11.1%.

**Grafiku 49 - Arritjet brenda dy viteve të ardhshme sipas gjinisë (2021)**





## **5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Shkalla e punësimit, e të papunëve, dhe joaktivëve është përkatësisht 58.8%, 20.3% dhe 19%. Të papunët e dekurajuar janë rreth 13.1%. Për sa i përket të punësuarve sipas gjinisë, meshkujt dominojnë në kategorinë e të punësuarve, 65.8% e meshkujve janë të punësuar, kundrejt 49.5% e femrave. Përqindjen më të lartë të punësimit, e kanë qendrat: Tiranë Nr. 1, DRFPP Durrës dhe Tiranë Nr. 4, ndërsa për sa i përket papunësisë, treguesin më të ulët e ka Qendra e Lëvizshme. Si rrjedhim, rekomandohet të bëhet një vlerësim më i detajuar për të evidentuar ato kurse që janë më të ndërlydhura me tregun e punës.

Krahasuar me shkallën e punësimit të marrë nga anketa kombëtare e gjurmimit për të certifikuarit e vitit 2019, shkalla e punësimit për të certifikuarit e vitit 2021, rezulton të jetë më e lartë: përkatësisht 58.8% (2021), në krahasim me 48.4% (2019).

26.2% kanë deklaruar të ardhura deri në 32.000 lekë, që korrespondon me pagën minimale në vend ndërsa vetëm 2.8% e të certifikuarve kanë deklaruar një pagë mbi 95.000 lekë. Këto të dhëna nuk kanë shumë ndryshim me të certifikuarit në vitin 2019, ku 22% kanë deklaruar të ardhura deri në 30.000 lekë dhe 3.5% një pagë mbi 95.000 lekë. Ky tregues përsëri tregon që është i nevojshëm studimi i tregut të punës.

Një indikator tjetër që mund të lidhet tërthorazi me performancën e kursit është dhe ndryshimi i të ardhurave pas kursit. Për të anketuarit e certifikuar në vitin 2021, 32.5% kanë deklaruar rritje, pas mbarimit të kursit të ndjekur. Ndërkohë që për të certifikuarit në vitin 2019, vetëm 28% kanë deklaruar rritje, përkundrejt 42.1% që kanë deklaruar rënie të tyre, ku shkaku kryesor mund të jetë dhe situata e pandemisë.

Nga analiza e të dhënave, vazhdon të ketë një dallim të rëndësishëm për sa i përket punësimit dhe të ardhurave sipas gjinisë. Gjithmonë meshkujt janë më mirë të integruar në tregun e punës dhe me të ardhura më të larta. 66.7% e femrave rezultojnë me një pagë deri në 40.000 lekë, përkundrejt 42.1% të meshkujve. Ky është një fenomen që shihet edhe në tregun e punës në Shqipëri.

49.4% e të punësuarve deklarojnë se puna e tyre ka lidhje me kursin profesional, ndërkohë që në lidhje me përdorimin e njohurive të marra, 57.6% e tyre i përdorin njohuritë shumë ose mesatarisht. Këta tregues mund të konsiderohen të kënaqshëm, sepse tregon që më shumë se 50% e të certifikuarve janë ndihmuar për t'u integruar në tregun e punës nëpërmjet njohurive të marra.

Për mënyrën e gjetjes së punës, sipas të dhënave, më shumë se gjysma e të anketuarve 56% e gjejnë punën nëpërmjet njohjeve familjare dhe vetëm 2.7% nga zyrat e punës.

Për të certifikuarit në vitin 2021, 67.5% e të vetëpunësuarve e shohin biznesin e tyre si një aktivitet të përhershëm të cilin ata duan ta vazhdojnë. Në përgjithësi shpërndarja e të vetëpunësuarve sipas qendrave është e balancuar, duke variuar nga rreth 10% deri në rreth 20%, ku specifikisht Shkodra rezulton qendra me numër më të madh të të vetëpunësuarve (20.3%) Në lidhje me kohën e hapjes së biznesit, për vitin 2021, 27.5% kanë deklaruar se e kanë hapur biznesin e tyre pas kursit, kundrejt 27.1% për vitin 2019. Për sa i përket madhësisë së biznesit, në përgjithësi flitet për biznese të vogla, ku vetëm 10.5% e të anketuarve në vitin 2021 kanë më shumë se 3 të punësuar, kundrejt 9.8% në vitin 2019.

Shkalla e papunësisë në total rezulton të jetë 20.3%, ku përqindja më e madhe e të papunëve është në qendrën e Lëvizshme me 38.3%, e ndjekur nga qendra e Korçës me 25%. Durrësi është qendra me përqindje më të ulët të papunësisë, me 16.1%. Ndërkohë sipas gjinisë, në përgjithësi për të gjitha qendrat, numri më i madh i të papunëve i përket femrave.

Nga treguesit rezulton se 40.8% kanë zgjedhur të ndjekin një kurs profesional për të rritur kualifikimet, kundrejt 21.1% që kanë për qëllim fillimin e një pune tjetër. Kjo tregon që të intervistuarit e përdorin kursin për t'u integruar sa më mirë në tregun e punës. Gjithashtu të intervistuarit janë të kënaqur me performancën në kurse, sepse rreth 86.2%, pavarësisht nga statusi i punësimit, do ta rizgjidhnin përsëri të njëjtin kurs.

Në lidhje me performancën e qendrave, pjesa më e madhe e të intervistuarve janë të kënaqur, si me kurrikulat, praktikën, tekstet, infrastrukturën etj. Nga të certifikuarit e vitit 2019 në vitin 2021, vihet re një përmirësim i treguesve, përveç "Bashkëpunimit me zyrat e punës", "Bashkëpunimit me bizneset", dhe "Këshillimit të Karrierës", ku ka ende hapësirë për përmirësim. Rritje të ndjeshme paraqesin treguesit që kanë të bëjnë me praktikën, si: praktika në biznes dhe praktika në qendër. Ky është një tregues i rëndësishëm, që pohon punën që qendrat kanë bërë në drejtim të integritit të praktikës me mësimdhënien.

Në lidhje me perspektivën për dy vitet e ardhshme, vetëm 16.6% dëshirojnë të emigrojnë jashtë vendit, një shifër akoma më e ulët se në vitin 2019, ku pjesa që dëshironte të emigronte ishte 20.8% e të certifikuarve. Të tjerët duan të punësohen apo të hapin bizneset e tyre. Kjo e dhënë tregon që pjesa më e madhe dëshirojnë të punësohen në vendin e tyre. Prandaj përmirësimi i mëtejshëm i ofertës dhe cilësisë së qendrave të formimit profesional, duhet të vijojë të jetë prioritet.

# SHTOJCA

## Rezultatet sipas qendrave

### 1. Orientimi dhe këshillimi i qendrave të formimit

